

MANJOLA ZAÇELLARI

**RRETH FUSHAVE KONCEPTORE BRENDA FUSHËS
FRAZELOGJIKE ME FJALËT ZEMËR E KOKË**

Abstrakti

Për të interpretuar fushat konceptore në frazeologji, mbështetemi në pasqyrimin e tyre në fjalorët e ndryshëm (qofshin këta shpjegues njëgjuhësh, qofshin dy e shumëgjuhësh). Ndërkohë, vërejmë se njësitë frazeologjike organizohen sipas gjymtyrës kryesore motivuese, metodikisht sipas gjymtyrëve që janë njësi shënuese (emra, mbiemra, folje, ndajfolje). Vetiu, kuptohet se organizimi këtu është formal dhe renditja e njësive bëhet alfabetikisht, sipas gjymtyrës që paraprin apo që ndjek gjymtyrën kryesore. Brenda grupit të njësive të ndryshme ka disa fusha konceptore. Në punimin tonë ne jemi ndalur në dy grupe të tilla njësisht për ta parë këtë dukuri, të fushat konceptore brenda fushës frazeologjike me fjalën zemër e me fjalën kokë. Në një punim të mëparshëm këtë dukuri e kemi parë edhe të fushat konceptore brenda fushës frazeologjike me fjalën sy¹.

Hyrje

Studimet gjuhësore në ditët e sotme, sidomos në fushën e semantikës leksikore strukturore, nuk mund të konceptohen apo të realizohen jashtë fushave gjuhësore. Jani Thomai pohon se: “*Fushë* quhet ajo tërësi lidhjesh të njësive gjuhësore (semantike, leksikore, leksiko-sesintaksore) që mbulohet nga një fjalë ose nga një grup fjalësh”².

Teoria e fushave e ka zanafillën e vet të paktën në mesin e shekullit të XIX dhe në mënyrë më të përgjithshme te idetë e Humboldt (1836), i cili mbahet si stërgjyshi shpirtëror i kësaj teorie, dhe të Herderit (1772). Ndërsa F. de Sosyri është përshëndetur në shumë mënyra si pararendës i saj.³ Megjithatë, koncepti i fushës, e njohur ndryshe edhe si *teoria e fushave* lidhet më së shumti me emrin e gjuhëtarit J. Trier, për të cilën studiuesi Ullman shprehet se “hapi një fazë të re në historinë e semantikës”⁴. Më pas idetë e tij u zhvilluan

¹ Shih për këtë M. Zaçellari, *Mendësia shqiptare te frazeologjia me fjalën sy*, Konferenca shkencore ndërkombëtare *Kërkime gjuhësore*, QSA, Tiranë, 2013, f. 271.

² J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 34.

³ *Shih më gjerë* V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejprësorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 24 – 46.

⁴ S. Ullmann, *Semantics*, Oxford Blackwell and New York, 1962, f. 7.

nga nxënësit e tij, sidomos nga Vaisgerber. Për Trierin fjalori i një gjuhe është si një sistem i integruar leksemash të lidhura nga ana kuptimore⁵. Pra, fjalori i një gjuhe është një grup i mbyllur leksemash, të cilat mund të jenë anëtare të një grupi fushash leksikore, d.m.th. të ndara brenda grupeve të tilla që:

- ndërprerja e dy fushave çfarëdo, të dallueshme, është e zënë, nuk është e lirë, d.m.th. asnjë leksemë nuk është pjesëmarrëse e më shumë se një fushe;

- bashkimi i të gjitha fushave në fjalor (V) është i barabartë me vetë fjalorin.⁶

Fushat konceptore brenda fushës frazeologjike me fjalën zemër

Frazeologjia lidhet ngushtë me kulturën dhe mendësinë e një populli. Njësitë frazeologjike me kuptim të njëjtë mund të kenë forma të ndryshme në gjuhë të ndryshme bazuar në tiparet dhe mendësinë e folësve të një gjuhe. Informacioni kulturor që përmbajnë njësitë frazeologjike nga njëra anë përfaqëson qasjen imagjinare kundrejt botës, ndërsa nga ana tjetër i jep vetë njësisë frazeologjike edhe ngjyrimin kombëtar e kulturor.

Studime të ndryshme për frazeologjinë, përqasja dhe dallimet mes njësisive na bëjnë të mundur të zbulojmë dhe përkufizojmë mendime logjike të popujve të ndryshëm si dhe karakteristikat e tyre dalluese. Disa studiues e konsiderojnë njësinë frazeologjike si atë njësi gjuhësore që shpreh mendësinë e një kombi dhe kulturën e tij. Gjuha bën të mundur që të perceptohet bota e jashtme si dhe ndërveprimin e folësve në një shoqëri. Humboldti e konsideronte gjuhën si një mjet që shërben për të shprehur ndjenjat dhe mendimet. Kështu ngjarjet psiko-emocionale ndikojnë në gjendjen e njeriut. Në këtë mënyrë ato arrijnë të pasqyrohen nëpërmjet gjuhës. Kështu, gjuha, pasqyron kulturën, traditat, historinë, mendësinë, arritjet shkencore e teknologjike të një shoqërie⁷.

⁵ J. Lyons, *Semantics*, Cambridge University Press, Cambridge, 1977, f. 249.

⁶ Shih më gjerë V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 24-46.

⁷ Shih për këtë: M. Baker, *The Mirror Principle and Morphosyntactic Explanation*, *Linguistic Inquiry*, 1985. Nr. 16. F. 373-415; M. Bamberg, *Emotional talk(s): the role of perspective in the construction of emotions*, II *The Language of Emotions*, Amsterdam, Philadelphia, 1997, f. 209-226; C. J. Fillmore *Frame Semantics II*, *Linguistics in the Morning Calm I*, Linguistics Society of Korea, Seoul, 1982, f. 11-138; R. W. Gibbs O'Brien J. E. *Idiom and Mental Imagery: The Metaphorical Motivation for Idiomatic Meaning II*, *Cognition* 36, 1990, f. 35-68; Lakoff G. *Frame Semantic Control of the Coordinate Structure Constraint II*, *Papers from the Parasession on Pragmatics and Grammatical Theory I* A. M. Farley et al (Eds.). Chicago, 1986, f. 152-167; G. Lakoff, *Women, Fire and Dangerous Things: What Categories Reveal about the Mind*. Chicago, 1987; G. Lakoff, Z. Kovecses, *The Cognitive Model of Anger Inherent in*

Në këtë punim jemi ndalur tek fushat konceptore brenda fushës frazeologjike të motivuara me fjalët *zemër* e *kokë*, pasi te njësitë që bëjnë pjesë në këto dy grupe mund të zbulosh të gjitha dukuritë, të rrafshit të përmbajtjes, të formës dhe të funksionit⁸.

Përgjithësisht, emërtimet për pjesët e trupit të njeriut, kanë bërë të mundur krijimin e shumë njësive frazeologjike. Kështu mjaft njësi frazeologjike ndërtohen me fjalët; *sy*, *dorë*, *faqe*, *hundë*, *këmbë*, *krah*, *lëkurë*, *vesh*, *zemër*, *kokë* etj. Kjo, padyshim ka bërë të mundur pasurimin dhe zgjerimin e mjeteve të shprehjes në ligjërim.

Njësitë e motivuara me fjalën *zemër* kanë përgjithësisht tipare të ngjashme me njësitë e motivuara me fjalën *shpirt* dhe në disa raste janë ekuivalente me njëra-tjetrën, si në shembujt: *ma do zemra -ma do shpirti*; *më dridhet zemra- më dridhet shpirti*; *heq në zemër- heq në shpirt*; *m'u copëtua zemra; m'u ça (m'u çor) zemra; m'u shqye zemra; m'u bë zemra (shpirti) copë; m'u nda zemra dysh; m'u copëtua shpirti; Ma copëtoi (ma thërmoi) zemrën; ma bëri zemrën (shpirtin) copë; ma dogji shpirtin; ma copëtoi shpirtin.; M'u ça (m'u çorr) zemra; m'u copëtua zemra; m'u këput shpirti; m'u dogj (m'u përvëlua, m'u zhurit) zemra (për dikë a për diçka; m'u bë zemra zhur; më çon zemra avull; m'u dogj (m'u përvëlua, m'u zhurit) shpirti; më mori flakë shpirti; s'ma do (s'ma heq) shpirti; m'u ngjeth zemra; më drithëron (më përpëlitet) zemra; m'u lëmek zemra; m'u drodh zemra; më drithëron shpirti; ma do zemra; më heq zemra (për diçka); ma do shpirti; s'ma do (s'ma heq) zemra; m'u drodh zemra; m'u err zemra sh. m'u err shpirti; më ka fjetur në zemër; më ka hyrë në zemër; më ka hyrë në shpirt; më ka fjetur në shpirt; kund. e nxjerr nga zemra; më gërvisht në zemër ; më këput shpirtin; më gërryen zemrën; më bren zemrën; më gërryen shpirtin; më hidhet zemra (përpjetë); më flakëron zemra; më gufon shpirti; më preku në zemër; më preku në shpirt; më gufon zemra; më goditi në zemër; M'u hap zemra; m'u ça (m'u çor) zemra; mu këput shpirti; më helmoi zemrën; më helmoi shpirtin; më heq zemra; ma do zemra; ma do shpirti; heq në zemër; heq në shpirt; më ka hyrë në zemër; më ka hyrë në shpirt; më iku zemra; më iku shpirti; i jap zemër (dikujt); i shtie shpirt; Nuk ka zemër ; nuk ka shpirt; E kam në (për) zemër (dikë a diçka); e kam shpirt; Ka zemër të fortë; ka shpirt të fortë; Ka zemër të gjerë; ka shpirt të gjerë; Ka zemër të keqe; ka shpirt të keq; Ka zemër të madhe; e ka zemrën të madhe; ka shpirt të madh; Ka zemër të mirë ; e ka zemrën të mirë; ka shpirt të mirë; Ka zemër të ngushtë (dikush); e ka zemrën të ngushtë; ka shpirt të ngushtë; ka zemër të vogël; e ka zemrën të vogël; ka shpirt të vogël; të kënaqet zemra të*

American English. II Holland D., Quinn, Cultural Models in Language and Thought. Cambridge, 1987; R. W. Langacker *A Usage-Based Model II Topics in Cognitive Linguistics I B*. Amsterdam, Philadelphia, 1988, fq.127-161.

⁸ *Shënim* Lënda e interpretuar është vjelë nga Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, J. Thomai, Tiranë, 2010.

kënaqet shpirti; të ka lent shpirti; Më këndon zemra; më këndon shpirti; m'u këput zemra (për dikë) sh. m'u këput shpirti (për dikë); e kam kyçur në zemër; e kam kyçur në shpirt; m'u lehtësua zemra; m'u lehtësua shpirti; më leqendisi zemrën; m'u këput shpirti; Më lëndoi në zemër; më lëndoi në shpirt; ma mbushi zemrën; ma ngopi zemrën; ma mbushi shpirtin (plot); m'u mbush zemra (plot); m'u ngop zemra; m'u ngroh zemra; m'u mbush shpirti (plot); m'u ndez zemra më mori flakë shpirti; ma ngopi zemrën; ma ngopi shpirtin; m'u ngop zemra; m'u ngop shpirti; më ngriu zemra; më iku shpirti; m'u ngroh zemra; m'u ngroh shpirti; më është ngulur (më është ngulitur) në zemër (dikush a diçka); më ka hyrë në zemër; më është ngulur (më është ngulitur) në shpirt.; ma nxiu (ma nxirosi) zemrën; ma bëri zemrën të ngjall; ma nxiu (ma nxirosi) shpirtin; më pikon në zemër; më pikon në shpirt; më plagosi zemrën; më lëndoi në shpirt; më plasi zemra; më preku në shpirt; më preku në zemër; m'u fry (m'u enjt) zemra; më plasi shpirti; Më qan zemra; më qan shpirti; m'u rëndua shpirti; m'u rëndua zemra; më rëndon në zemër; më rëndon në shpirt; më sëmbon në zemër; më dhemb (më ther) shpirti (në shpirt); më shkriu zemra; më erdhi zemra (shpirti) në vend; ma thau zemrën; ma thau shpirtin; më vlon në zemër; më vlon në shpirt; me zemër të keqe; me shpirt të keq; me zemër të pastër (të kulluar); me shpirt të pastër (të kulluar); me shpirt të qëruar; me shpirt të plagosur; me zemër të plagosur; me zemrën plot; me shpirtin plot; me zemër të plotë; me gjithë shpirt; me zemër të vogël; me shpirt të vogël; me zemër të vrarë; me shpirt të vrarë; me shpirt të zi; me zemër të zjarrtë; me zemër të zezë etj.

Në gjuhën shqipe fjalët e mëposhtme lidhen me shpirtin njerëzor: *marr frymë, zemër, arsye, mendje, karakter, shqetësim, mençuri, moral, shëndet, forcë, jetë, botë e brendshme, dashuri, vuajtje* etj., të cilat përcaktojnë veprimtarinë e njeriut, sjelljen dhe këndvështrimet e tij. Studiuesit kanë zbuluar se janë faktorët leksiko-semantikë që luajnë rolin kryesor në formimin e njësive frazeologjike dhe jo faktorët gramatikorë.

Parë nga pikëpamja semantike, përmbajtja e këtyre njësive është shpesh e afërt, madje edhe e njëjtë, në gjuhë të ndryshme. Ajo që bën ndryshimin është ndërtimi, struktura e tyre për arsye se gjuhë të ndryshme përdorin terma të ndryshëm, për shembull për *vdekjen*. Por, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze, italiane, franceze, bullgare, ruse etj., të gjitha formimet me fjalën *vdekje* nënkuptojnë ndarjen e trupit dhe shpirtit apo shpirti, i cili i largohet trupit. Prej këndeje, ne mund të flasim për universale gjuhësore, sa kohë kemi ngjashmëri në kuptimin leksikor të fjalëve⁹.

⁹ Shih për këtë: S. Lindner *What Goes Up Doesn't Necessarily Come Down: The Ins and Outs of Opposites*, II Chicago Linguistic Society, 1982. Nr. 18, f. 305-323; A. Ortony, T. Turner, *What's Basic about Basic Emotions?* II Psychological Review, 1997, f. 315-331; E. Rosch, *Cognitive Representations of Semantic Categories*. II Journal of Experimental Psychology: 1975 (b), Nr. 104 (3), f. 192-

Le të shqyrtojmë tani njësitë frazeologjike *me gjithë zemër; me mish e me shpirt*, që nënkuptojnë: “me tërë trupin”, apo “me tërë qenien”. Vetë qenia njerëzore përkufizohet si *një tërësi prej mishi e shpirti, që është e aftë të mendojë, të flasë* etj. Ky është një përkufizim që e hasim tek të gjitha gjuhët. Kështu kuptimi leksiko-semantik i njësisë frazeologjike *me gjithë zemër, përkatësisht me mish e me shpirt* kuptohet në të njëjtën mënyrë në gjuhë të ndryshme dhe do të thotë: “*me gjithë shpirt, me tërë qenien*”.

Fjala *zemër* përcaktohet si qendrore, si burim dhe si origjinë e së brendshmes shpirtërore të njeriu. Zemra nuk është vetëm vendi ku “mbahen emocionet”, por është gjithashtu qendra e jetës shpirtërore psikologjike dhe fizike. Kështu zemrës i atribuohen të gjitha funksionet e ndërgjegjes, si: aftësia për të menduar, dëshirat, vendimet, ndërgjegjja, si të shembujt: *më këndon zemra; më thyhet zemra; me zemër në duar* etj. Një leksemë e ngjashme me fjalën *zemër* mund të gjendet te njësitë frazeologjike që përdoren për të shënuar marrëdhënien ndërmjet shpirtit njerëzor dhe tipareve fizike përkundrejt objekteve në univers.

Njësitë frazeologjike që mund të kombinohen me predikate të ndryshme mund të kenë forma të ndryshme me kuptime të ndryshme¹⁰. Forma të tilla mund të përshkruajnë një univers të tërë: ndjenjat e ndryshme njerëzore; natyrën psikologjike njerëzore; kujtesën; procesin e të menduarit etj. Dihet që dëshirat njerëzore, qëllimet, emocionet dhe bota e brendshme e kanë vendin të gjitha në zemër dhe hapja e zemrës bën të mundur që të dalë i gjithë informacioni i fshehur aty. P.sh. *i hap zemrën (dikujt)- “i tregoj dikujt një sekret”* etj.

Jemi shprehur, se ndër të tjera njësitë frazeologjike shprehin edhe botën shpirtërore të njeriut. Kështu, nëse e krahasojmë njësinë frazeologjike të shqipes *i thyej zemrën* (dikujt) – “*e zhgënjej dikë*” apo “*e ofendoj dikë*” me të njëjtën njësi në anglisht (“to break someone’s heart”), apo italisht (*spezzare il cuore*) do të vërejmë se kuptimi është i njëjtë në të tri gjuhët, po ashtu dhe struktura gramatikore. Njësia lidhet me fjalën “*thyej*”, sepse në të tri gjuhët nënkupton “ta shkatërrosh diçka”.

233; E. Rosch, *Human Categorization. II Studies in Cross-Cultural Psychology*, Vol.1 /N. Warren (Ed.). N.Y. and London, 1977, f. 1-49.

¹⁰ E. Rosch, *Linguistic Relativity. II Human Communication: Theoretical Explorations I*, E. Silverstein (Ed.). New York, 1974, f. 95-121; E. Rosch, *Natural Categories. II Cognitive Psychology*. 1973 (b). Nr. 4. F. 328-350; E. Rosch, *On the Internal Structure of Perceptual and Semantic Categories II*, *Cognitive Development and the Acquisition of Language I* T.E. Moore, New York, 1973 (a), f. 111-114; E. Rosch, *Principles of Categorization. II Cognition and Categorization I* E. Rosch and B. L. Lloyd (Eds.). Hillsdale, N. J., 1978, f. 27-47

Zemra, si organ që lidhet me emocionet, është ndër të tjera e lidhur edhe me dhimbjen (*dhimbje zemre*), që në shqipe shpreh shqetësim, mërzitje, hidhërim. Edhe në këtë rast, po ta krahasojmë me të njëjtën njësi në anglisht (*heart-ache*)- “ndjenjë e fortë mërzie apo shqetësimi, apo italisht (*cuore malato*) do të vërejmë se në të tria gjuhët njësitë kanë ngjashmëri si në përmbajtje ashtu dhe në formën gramatikore.

Njësitë e motivuara me fjalën *zemër* i kemi grupuar sipas fushave konceptore që shprehin:

- **dashuri:** *i anon zemra; m'u copëtua zemra; m'u ça (m'u çor) zemra; m'u shqye zemra; m'u bë zemra (shpirti) copë; m'u nda zemra dysh; m'u copëtua shpirti; ma copëtoi (ma thërrmoi) zemrën ; m'u ça (m'u çorr) zemra; m'u dogj (m'u përvëlua, m'u zhurit) zemra; ma dogji (ma përvëloi, ma zhuriti) zemrën; e fut në zemër; më ka hyrë në zemër (dikush a diçka); më është ngulur (më është ngulitur) në zemër; më ka fjetur në zemër; m'u ngjit në zemër; e kam në (për) zemër; më ka hyrë në shpirt; i jap zemrën; i fal zemrën; e kam në (për) zemër; më ka hyrë në zemër; më punon zemra (për dikë a për diçka); e kam kyçur në zemër; nuk e nxjerr nga zemra; e mbaj në zemër; ma mori zemrën; më fitoi (më rrëmbeu, më grabiti) zemrën; e mbaj në zemër; nuk e nxjerr nga zemra; ka mbetur në zemrën time; e ruaj në zemër; më ka hyrë në zemër; m'u ngjit në zemër; e ruaj në zemër nuk e nxjerr nga zemra; më rreh (më troket) zemra etj.*

- **trimëri:** *ka zemër të fortë; ka zemër luani; me shtatë palë zemra; me zemër luani etj.*

- **urim:** *me zemër të mirë!*

- **lumturi/gëzim:** *më flakëron zemra; më gufon zemra; më hidhet (me brof) zemra (përprjetë); më këndon zemra; më ligjëron zemra; më lulëzon zemra; m'u mbush zemra plot; më qesh zemra; m'u rrit zemra; me zemër të gëzuar; m'u zgjerua zemra etj.*

- **shqetësim/ hidhërim:** *m'u fry (m'u enjt) zemra; më gërvisht në zemër; më gërren zemrën; më helmoi zemrën; m'u mblodh zemra lësh; m'u mbush zemra me helm; m'u ngushtua zemra; ma nxiu zemrën; m'u nxi (m'u nxiros) zemra; m'u rëndua zemra; më shpi zemrën; m'u shtrëngua zemra etj.*

Fushat konceptore brenda fushës frazeologjike me fjalën *kokë*

Po kaq interesante është dhe fusha konceptore brenda fushës frazeologjike me fjalën *kokë*. Psikolinguistika i sheh njësitë frazeologjike si elemente emocionale të dekoduar nëpërmjet hemisferës së majtë e të djathtë. Fjalët me ngjyrim emocional aktivizohen në zona të tjera të hemisferës së majtë, si te korteksi orbitofrontal e amigdala. Këto zona i përkasin sistemit limbik dhe luajnë rol të rëndësishëm në formimin e emocioneve. Të dhënat e shumta që vijnë nga studimet mbi sjelljen, psikologjinë etj., pohojnë se në formimin e fjalëve me ngjyrim emocional përfshihen të dyja hemisferat, megjithëse në mënyra të ndryshme e hera-herës komplementare.

Duke parë njësitë frazeologjike të motivuara me fjalën *kokë* arrijmë të ndërtojmë një tablo të inteligjencës dhe psikologjisë e mendësisë kombëtare. Ne nisemi nga fakti që koka është ai organ i njeriut që “mban” inteligjencën. Ndaj dhe në shumë njësi frazeologjike me fjalën *kokë* shënjohe shenjohe pikërisht kjo gjë, si te njësitë: **(Sa) i di koka** (dikujt) është i zgjuar e i shkathët, nuk ia hedh dot; di të sigurojë gjithçka për vete; **(sa) i di lëkura;** **(sa) i di rradakja** thjeshtligj. - Sa të di koka, bre! A thua ne të tjerët s'marrim vesh se ç'bëhet! (Let. art.); **E ka mendjen (i ka mendtë) në kokë** (dikush). 1. Është në gjendje të arsyeojë vetë, gjykon vetë; është i mençur; kund. **e ka mendjen (i ka mendtë) prapa kokës**. 2. Është i përmbajtur, nuk flet a nuk vepron pa i matur e pa i peshuar mirë gjërat; e zotëron dhe e kontrollon veten. - Ti, Zana, në fillim e more ca për ters Agronin, mirëpo tashti e sheh që ai është djalë i mirë, i ka mendtë në kokë. Po të pëlqen? (Let. art.). **Kokë e madhe** njeri i shquar, mendimtar i madh a personalitet i njohur, njeri shumë i zgjuar e i ditur; **mendje e ndritur**. - Ajnshtajni ka qenë kokë e madhe, këtë e dinë të gjithë, - i tha Selma. - Ti, o mësues, je akoma larg. (Let. art.); **I pjell koka** (dikujt) sh. **i pjell mendja** (dikujt). - A, për ashtu, i pjell koka atij dhe s'ia ha qeni shkopin. (Ligj. fol.). -Ja, sa i vogël është dhe i pjell koka lloj-lloj marifetesh, - tha nëna. -Shejtani është. (Let. art.). **I punon koka** (dikujt) është i zgjuar, ka aftësi mendore; ka fantazi; **i pjell koka;** **i punon mendja;** **i punon truri**. Në klasën e parë kemi pasur një mësuese të mirë, e dashur si nënë dhe që i punonte koka për të na bërë të gëzuar. (Let. polit.-shoq.).

Siç shihet nga shembujt, si sinonime me fjalën *kokë* kemi fjalët *rradake*, *mendje*, *lëkurë*, *tru*, *kaptinë*, nëpërmjet të cilave shënjohe e njëjta gjë – inteligjenca, zgjuarsia, shkathhtësia, dituria. Njësitë frazeologjike të formuara me këto gjymtyrë kanë gati strukturë të njëjtë, si: **i bëri kokën, i ka bërë kryet, i ka bërë radaken** etj., por dallojnë nga njëra-tjetra nga ngjyrimi emocional që përmbajnë fjalët: *kokë*, *krye*, *rradake*.

Njësi të tilla janë formime *folje + emër*, ku kuptimi i foljes lidhet me diturinë, aftësinë, si tek: **(sa) i di koka** (dikujt) është i zgjuar e i shkathët; **(sa) i di lëkura;** **(sa) i di rradakja** thjeshtligj., **i pjell koka** (dikujt) sh. **i pjell mendja** (dikujt), **i punon koka** (dikujt) është i zgjuar, ka aftësi mendore; ka fantazi; **i pjell koka;** **i punon mendja;** **i punon truri** etj. apo formime *emër + mbiemër*, ku mbiemri ashtu si folja shënjon pikërisht inteligjencën, zgjuarsinë, si tek njësitë: **kokë e madhe** njeri i shquar, mendimtar i madh a personalitet i njohur, njeri shumë i zgjuar e i ditur; **mendje e ndritur**.

Interesant është dhe një formim metonimik i njësisë frazeologjike *ku më ka rënë koka*, që përfaqëson tërë ekzistencën, jetën, vetë individin shoqëror. Në fakt, ka një grup njësisish frazeologjike të motivuara me fjalën *kokë* që shënjojnë jetën, megjithëse ky grup, në krahasim me njësitë që shënjojnë vdekjen është më i vogël. **i ka bërë kokën** (dikujt) *e ka lindur;* **i ka bërë kryet;** **i ka bërë radaken** thjeshtligj. etj.

Nga shembujt e qëmtuar, *koka* na del si koncept qendror në mënyrën e të kuptuarit të jetës, të vdekjes, dashurisë, zgjuarsisë etj.

Kështu për të shenjuar **dashurinë** kemi njësitë: **jap kokën** (për dikë a për diçka). e dua shumë, jap edhe jetën për të; **jap kryet; lë kokën** (për dikë a për diçka). 1. E dua shumë, e vlerësoj aq shumë sa jam gati të bëj çmos për të. 2. Jap jetën për dikë, vdes për të; sakrifikohem për të. 3. v. III. Vdiq; u vra; **la kryet; e la rrashtën; la kaptinën** thjeshtligj.; **la lëkurën; la kockat; la rruazën**. Kryesisht këto janë krijime metonimike; përshkrimi i një aspekti të veprimit shërben për të shenjuar vetë veprimin.

Një fushë semantike të gjerë përbëjnë njësitë frazeologjike të motivuara me fjalën kokë që shënojnë **vdekje**, të cilat siç pohuam më sipër janë më të shumta në numër, si: **Të fluturon (të ikën) koka** të pret dënimi i madh, të pret vdekja; **të fluturon (të ikën) kryet; të fluturon (të ikën) kaptina** thjeshtligj. **I hapi kokën** (dikujt). 1. E goditi rëndë, e plagosi në kokë; e vrau; **i hapi kafkën; i hapi trutë; i hapi kaptinën** thjeshtligj. 2. I nxori telashe të mëdha; e mërzi shumë.; **I iku (i shkoi) koka** (dikujt) e vranë, i morën jetën; **vdiqi iku (i shkoi) kaptina** thjeshtligj.; **Ia këputi kokën**. 1. (dikujt). E vrau, e mbyti; e zhduku pa mëshirë; **ia shtypi kokën; ia përdrodi kokën**. 2. (diçkaje). E ndaloj prerazi, nuk e la më të vijoje, të zhvillohet, të bëhet etj.; **i vuri kapak (kapakun); ia këputi kryet.; Ia kripi kokën** (dikujt). 1. përb. E vrau; e zhduku nga faqja e dheut. 2. Ia zuri shumë shtrenjtë diçka, i mori shumë para për diçka; **ia lau kokën.; E pagoi (e lau) me kokë** (dikush) e pësoi shumë rëndë për një veprim që ka bërë, humbi edhe jetën; i kushtoi shumë shtrenjtë një veprim.; **Ia përdrodi kokën** (dikujt) përb. e vrau; e zhduku pa mëshirë; **ia këputi kokën; ia përdrodi kryet; ia përdrodi qafën.; Ia shtypi kokën** (dikujt) e shkatërroi krejt, e asgjësoi pa meshirë, e zhduku përfundimisht; e vrau me egërsi; **ia shtypi kryet; ia shtypi (ia këputi) kaptinën** thjeshtligj.; **I vajti koka** (dikujt) u vra, vdiq; mbaroi; **i vajti rradakja** thjeshtligj.

Konotacionet kulturore lindin si rezultat i ndërveprimit mes kuptimit gjuhësor dhe kodeve të tjera simbolike kulturore dhe formojnë një fushë respektive të përbashkët për të dyja kuptimet verbale dhe jo-verbale. Dihet që jeta dhe vdekja janë konstrukte themelore, të cilat në kushtet e një qasjeje antropocentrike, qëndrojnë në qendër të vizionit botëror kulturor dhe gjuhësor¹¹.

Parametrat konceptuale të jetës përfaqësohen nëpërmjet dy metaforave, kohore dhe hapësinore. Kështu, krijime nëpërmjet metaforës hapësinore kemi ato krijime që shënojnë fillimin apo fundin e ekzistencës individuale: **i bëri kokën; la kokën** etj. Gjithashtu, fillimi i një faze të re në jetën e dikujt është shpesh subjekt për interpretimin metaforik në aspektin e hapësirës.

¹¹ A. P. Cowie, *Phraseology as a Language of Culture: Its Role in the Representation of a Collective Mentality* në *Phraseology, Theory, Analysis and Applications*, Oxford, 1998, f. 61.

Por, edhe vdekja, shihet gjithashtu si nisje në një hapësirë të re (**i vajti koka** (dikujt) u vra, vdiq; mbaroi). Edhe në këtë rast, parametrat që përshkruajnë kuptimin formojnë shoqërizimin me metaforat e kohës dhe hapësirës, ndërsa përzgjedhja e nënndërgjegjes kulturore përcakton llojin e hapësirës që do të aktivizohet në ato formime metaforike që ndodhin rregullisht.

Brenda grupit të njësive frazeologjike me fjalën kokë që shënojnë vdekje mund të bëjmë ndarjen e mëposhtme:

-njësi frazeologjike me fjalën kokë që shenjojnë mënyrën se si dikush i ka shkaktuar vdekjen dikujt, si: *i hapi kokën, ia këputi kokën, ia shtypi kokën, ia përdrodhi kokën; ia këputi kryet.; Ia kripi kokën, Ia shtypi kokën*, etj.

-njësi frazeologjike që shenjojnë fundin, ikjen nga kjo botë, si: *i iku (i shkoi) koka* (dikujt); *i iku (i shkoi) kryet; i iku (i shkoi) kaptina thjeshtligj*.

Përgjithësisht, edhe këto formime janë metonimike, por që funksionojnë si metafora. Në disa prej këtyre njësive zbulohen veprime që njeriu i kryen me kafshën, por që në frazeologji marrin kuptimin e vdekjes, si: *ia shtypi kokën, ia përdrodhi kokën, ia këputi kryet.; ia kripi kokën* etj.

Mund të shihet nga këto ilustrime se konceptualizimi metaforik i jetës dhe vdekjes në frazeologjinë shqipe është i ngarkuar me ngjyime kulturore dhe në ndonjë rast dhe etnografike, si tek shembulli *kokë turku*.

Konotacionet kulturore mundësojnë gjetjen e lidhjeve sistematike mes gjuhës së përditshme dhe ligjërimi të tjera joverbal-kulturore. Dihet që çdo kulturë ka veçantitë e saj në perceptimin dhe kuptimin që i jep vdekjes, po ashtu dhe ritualet apo doket zakonore.

Si përfundim do të thoshim se ashtu si *koka* edhe *zemra*, përveç funksionit të saj si organ biologjik ka fituar dhe funksione të tjera me ndihmën e fantazisë apo shoqërizimit. Gjuha na tregon që zemra është qendra në të cilën gjenden kuptimet, të ndërgjegjshme dhe të pandërgjegjshme. Zemra është vendi ku janë përqendruar shpirti dhe trupi, mëkatet, ndjenjat dhe emocionet, mendimet dhe dëshirat. Me gjithë karakteristikat e njëjta në gjuhë të ndryshme, njësitë frazeologjike me fjalën *zemër*, kanë për çdo gjuhë, respektivisht dhe për shqipen tipare dalluese që lidhen me shpirtin njerëzor.

BIBLIOGRAFI

- A. Ortony, T. Turner, *What's Basic about Basic Emotions? II* Psychological Review, 1997.
- A. P. Cowie, *Phraseology as a Language of Culture: Its Role in the Representation of a Collective Mentality*, Phraseology, Theory, Analysis and Applications, Oxford, 1998.
- C. J. Fillmore, *Frame Semantics II, Linguistics in the Morning Calm I*, Linguistics Society of Korea, Seoul, 1982.

- E. Rosch, *Cognitive Representations of Semantic Categories*. II Journal of Experimental Psychology: 1975 (b), Nr. 104 (3).
- E. Rosch, *Human Categorization*. II *Studies in Cross-Cultural Psychology*, Vol.1 /N. Warren (Ed.). N.Y. and London, 1977.
- E. Rosch, *Linguistic Relativity*. II *Human Communication: Theoretical Explorations I*, E. Silverstein (Ed.). New York, 1974.
- E. Rosch, *Natural Categories*. II *Cognitive Psychology*. 1973 (b). Nr. 4.
- E. Rosch, *On the Internal Structure of Perceptual and Semantic Categories II*, Cognitive Development and the Acquisition of Language I T.E. Moore, New York, 1973 (a).
- E. Rosch, *Principles of Categorization*. II *Cognition and Categorization I* E. Rosch and B. L. Lloyd (Eds.). Hillsdale, N. J., 1978.
- G. Lakoff, *Frame Semantic Control of the Coordinate Structure Constraint II*, Papers from the Parasession on Pragmatics and Grammatical Theory I A. M. Farley et al (Eds.). Chicago, 1986.
- G. Lakoff, *Women, Fire and Dangerous Things: What Categories Reveal about the Mind*, Chicago, 1987.
- G. Lakoff, Z. Kovecses, *The Cognitive Model of Anger Inherent in American English*. II Holland D., Quinn, Cultural Models in Language and Thought. Cambridge, 1987.
- J. Lyons, *Semantics*, Cambridge University Press, Cambridge.
- J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.
- M. Baker, *The Mirror Principle and Morphosyntactic Explanation*, Linguistic Inquiry, 1985. Nr. 16.
- M. Bamberg, *Emotional talk(s): the role of perspective in the construction of emotions*, II *The Language of Emotions*, Amsterdam, Philadelphia, 1997.
- R. W. Gibbs O'Brien J. E. *Idiom and Mental Imagery: The Metaphorical Motivation for Idiomatic Meaning II*, Cognition 36, 1990.
- R. W. Langacker, *A Usage-Based Model II Topics in Cognitive Linguistics I B.*, Amsterdam, Philadelphia, 1988.
- S. Lindner, *What Goes Up Doesn't Necessarily Come Down: The Ins and Outs of Opposites*, II Chicago Linguistic Society, 1982, Nr. 18.
- S. Ullmann, *Semantics*, Oxford Blackwell and New York, 1962.
- V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999.